



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P.637/2014

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gentian Këri	Kryetar
Juliana Hoxha	Anëtar
Spiro Kuro	Anëtar
Leonard Gremshi	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.12.2014 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: “Kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “ikubINFO” sh.p.k., dhe skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Stroka produkt” sh.p.k dhe “IN2” sh.p.k për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*” me objekt: “*Zhvillimi dhe Implemetimi i Business Intelligence (BI)*”, me fond limit 23 333 333 (njëzet e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 10.11.2014 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Ankimues: “ikubINFO” sh.p.k.
Adresa: Rruga “Murat Toptani”, Gjergji Center kati VII , Tiranë

Palë e ankimuar: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
Adresa: Rruga “Gjin Bue Shpata”

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, z. Leonard Gremshi, znj. Juliana Hoxha dhe z. Spiro Kuro, shqyrtauan parashtrimet me shkrim të ankesuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutuan çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.10.2014 është publikuar në portalin elektronik të prokurimeve, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*” me objekt: “*Zhvillimi dhe Implemetimi i Business Intelligence (BI)*”, me fond limit 23 333 333 (njëzet e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 10.11.2014 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

II.2. Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë:

1. “Adrenalinë” sh.p.k pa ofertë skualifikuar
2. “Stroka produkt” sh.p.k dhe “IN2” sh.p.k (JV bashkim operatorësh) me ofertë 20.177.025 lekë pa TVSH kualifikuar
3. “IkubInfo” sh.p.k me ofertë ekonomike 21.933.330 lekë pa TVSH skualifikuar

II.3. Në datën 26.11.2014 operatori ekonomik “ikubINFO” sh.p.k është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij nga kjo procedurë prokurimi me arsyen e mëposhtme:

“Vërtetimi i sjellë nga OSHE nuk është konform kërkesave të VKM nr. 379 datë 14.06.2014, dhe nuk pasqyron pagesën e detyrimit të fundit të maturuar”

II.4. Në datën 02.12.2014 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikim e tij.

II.5. Në datën 04.12.2014 autoriteti kontraktor, me anë të shkresës nr. 26480/6 prot. datë 04.12.2014 i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke kundërshtuar ankimimin e tij dhe duke lënë në fuqi vendimin e KVO-së.

II.6. Në datën 12.12.2014 operatori ekonomik ankimues, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ku kërkon:

“Në datën 26.11.2014 ka ardhur njoftimi mbi kuotimin e operatorëve ekonomike pjesëmarrës në tender, ndër të cilët operatorët që kanë dhënë ofertë ekonomike ishin kompania Stroka Produkt d.o.o dhe ikubINFO.

Aryesja e refuzimit të ofertës tonë ekonomike nga tenderi është se vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike nuk pasqyron shlyerjen e detyrimeve të maturuara të muajit të fundit si dhe operatori ekonomik nuk ka paraqitur konform kërkesave të VKM nr. 379 datë 11.06.2014 vërtetimin e lëshuar nga OSHE pasi në të nuk pasqyrohet shlyerja e detyrimeve të periudhës së fundit të maturuar. Në përgjigje të këtij pretendimi nga ana e autoritetit në deklarojmë nën përgjegjesinë tonë të plotë se ikubINFO shpk nuk është palë kontraktuale me OSHE-në dhe në këtë kuptim ne nuk kemi kontratë furnizimi të energjisë elektrike me këtë Institucion.

Ne dokumentat standarte të tenderit Shtojca 7, "Kapaciteti ekonomik dhe financiar", pika 3 është kërkuar nga ana e Autoritetit:

Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i rregjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara, në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5(pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.

Në kuptim të VKM Nr.379, datë 11.06.2014 mbi bazën e të cilës është vendosur kërkesa e mësipërme, paraqitja e vërtetimit që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike shprehimisht kërkohet për kontratat e energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Ritheksojmë se ikubINFO shpk nuk ka kontrata të furnizimit me energji elektrike me OSHE-në.

Pra subjekt i kësaj kërkesë është operatori ekonomik i cili ka një kontratë furnizimi të energjisë elektrike me OSHE dhe si palë kontraktuale duhet të vërtetojë përmbushjen e detyrimeve të tij përkundrejt këtij Institucioni.

Për të vërtetuar se nuk jemi subjekt i kërkesës së sipërpërmendur, ne, si operator ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë kemi paraqitur një vërtetim të lëshuar nga vetë Institucioni OSHE ku në faqen e dytë të këtij vërtetimi paraqitet lista e kontratave të furnizimit të energjisë elektrike për të cilat lëshohet vërtetimi.

Në këtë listë nuk rezulton se ikubINFO është kontraktues i OSHË-së, por figuron një kompani tjetër ITD shpk. Pra, vërtetimi i paraqitur nga ne nuk ka për qëllim vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve të maturuara, por vërtetimin nga vet Institucioni i OSHË-së se ne nuk jemi palë kontraktuale e saj dhe rrjedhimisht nuk jemi subjekt i kësaj kërkesë.

Duke qene se ne nuk jemi subjekt i kërkesës së shprehur në DST dhe për të provuar vërtetësinë e pohimeve tona, ne kemi dorëzuar këtë vërtetim tek Autoriteti me qëllim paraqitjen e një dokumenti zyrtar nga vet Institucioni përgjegjës (dhe jo një vet deklaram) i cili shpreh se ne nuk kemi kontratë furnizimi të energjisë elektrike. Në këtë mënyrë autoriteti do të kishte ta plota të gjithë informacionin në lidhje me statusin tonë si palë kontraktuale apo jo me OSHË-në dhe faktit nëse jemi apo jo subjekt i kësaj kërkesë.

Përsa më sipër, vlerësimi mbi kualifikimin e ofertës tonë nga ana e autoriteti nuk duhet të bëhej mbështetur në një kërkesë të cilën ne nuk mund ta plotësojmë si pasojë e statusit tonë.

Referuar VKM Nr.1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", Kreu V "Zhvillimi i procedurave", pika 4 "Hapja dhe vlerësimi i ofertave", paragrafi 3, i pikës 9), i cili shprehet:

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë vetëm me shkrim ose të reflektuara në proçeverbalin e prokurimit. Bazuar në ofertat e pranuar, komisioni i vlerësimit harton klasifikimin përfundimtar dhe e komunikon atë në kohën e përcaktuar si dhe ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, Neni 53 "Shqyrtimi i ofertave" i cili shprehet:

Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave.

Për të qenë sa më të drejtë në vlerësimin e ofertës tonë në mënyrë që të mos nxjerrë një vendim të padrejtë, autoriteti duhet të na drejtohej ne për të dhënë sqarime në lidhje me kontratat e furnizimit me energji elektrike apo edhe për të administruar një vërtetim tjetër debie nga OSHË i cili përsëri do të vërtetonte të njëjtit pohim me vërtetimin e parë, se ikubINFO nuk ka kontrata të energjisë elektrike me këtë Insitucion.

Ndërsa VKM Nr.1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", Kreu V, pika 4, gërma gj), shprehet se:

gj) Nëse ka dyshime, autoriteti kontraktor verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga ofertuesit.

Në mbështetje të bazës ligjore të mësipërme autoriteti ka detyrimin ligjor për tu drejtuar OSHË-së për të vërtetuar nëse kemi apo jo kontratë me ta.

Pësa më sipër në vendimin e tij për skualifikim autoriteti kontraktor nuk shprehet që ka kryer këtë verifikim dhe të dhënat tona nuk përkojnë me informacionin. Përkundrazi bazohet vetëm në vlerësim të gabuar dhe jo substancial në bazë të të cilit duhet të ishte vlerësuar oferta jonë si subjekt ose jo si kriterit kualifikues dhe nëse do të verifikohet se ne ishim palë kontraktuale me OSHË-ne atëherë të jepej vendimi për mosshlyerje të detyrimeve të maturuara.

Në përgjigjen e tij të datës 04.12.2014, autoriteti shprehet se:

Duke ju referuar vërtetimit nr.28Prot., datë 27.10.2014, të paraqitur nga ana juaj rezulton se për kërkesin ikubINFO shpk, të përfaqesuar nga Z Besjan Xhuglini, pas verifikimeve të kryera në sistemin e fatutritit titullar i të cilave është ikubINFO rezulton se ky vërtetim nuk përfshin të likujduar detyrimet në periudhën me të fundit të maturuar në harmoni me VKM Nr.379, datë 11.06.2014.

Në këtë përgjigje duket qartë se nëse autoriteti do të kishte përmbushur detyrimet e tij ligjor për të vlerësuar një ofertë në themel dhe tërësi dhe jo vetëm në pamje të parë atëherë duhet të kishte bërë një analizë me e hollësishme ndaj detyrimeve të ikubINFO tek OSHË. Në interpretimin ligjor që duhet ti bëhej një dokumenti duhet të shqyrtohet në tërësi dhe jo i diferencuar në paragrafet e veçanta të tij, ku autoriteti mbështetet vetëm tek paragrafi i parë i këtij vërtetimi. Nëse do ti referohemi edhe faqes së dytë të po këtij vërtetimi debie do të verifikohet se kontrata e energjisë për të cilën është lëshuar ky vërtetim është e shoqërisë ITD shpk e cila në kuptim të kontratës së furnizimit me energji elektrike e nënshkruar me OSHË ajo është titullare e faturave të cilat në sistemin e faturimit lëshohen në emër të ITD shpk.

Në kuptim të Kodit Civil, pjesa IV, Kreu I, shprehet se detyrimi është një marrëdhënie juridike me anë të së cilës një debitori detyrohet të japë diçka të caktuar në dobi të kreditorit, i cili ka gjithashtu të drejtë të kërkojë ti jepet diçka si dhe detyrimet lindin nga ligji ose kontrata. Në rastin konkret duke qenë se ne nuk kemi kontratë me OSHË-ne atëherë rrjedhimisht nuk kemi asnjë detyrim kundrejt shlyerjes së detyrimeve dhe për këtë OSHË ka shprehur në vërtetim se ikub/NFO rezulton të ketë në total 0.00 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike.

Detyrimin primar për shlyerjen e faturave të energjisë elektrike e ka titullari legjitim i tyre, pra ITD shpk e cila citohet në vërtetim si titullar i vetëm i këtyre faturave dhe për të vërtetuar se ikubINFO në datën e tenderit dhe pas tij nuk ka asnjë kontratë furnizimi me energji elektrike me OSHË-në bashkëngjitur po ju dërgojmë vërtetimin nr.33Prot., datë 03.12.2014.

Në mbështetje të Ligjit të Prokurimit Publik si dhe VKM-të në fuqi për rregullat e prokurimit publik oferta jonë është ofertë e cila i plotëson të gjitha kualifikimet ligjore, financiare dhe tekniko-profesionale dhe si e tillë duhet të vlerësohet si ofertë e kualifikuar dhe jo të penalizohet për mospërmbushje të një detyrimi i cili për ne nuk ekziston.

Në përputhje me nenin 12 të LPP-së, autoriteti është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe nuk duhet të skualifikojë një ofertë ekonomike të përgjegjshme për arsye të pabazuara në ligj. Neni 1 i LPP-së shprehet ndër të tjera se qëllimi i ligjit është të sigurojë mirëpërdorimin e fondeve publike dhe të ulë shpenzimet proceduriale, por në këtë rast autoriteti nuk i ka respektuar parimet dhe qëllimin e këtij ligji. Vendimet e autoritetit nuk duhet të jenë në kundërshtim me parimet e ligjit të Prokurimit Publik, sipas të cilit duhet të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët.

Autoriteti shprehet se ankimimi jonë është i pambështetur në prova dhe në ligj, por realisht për të gjitha arsyet e sipërcituara vendimi i autoritetit nuk është i mbështetur në prova, ligj dhe argumentim ligjor.

Përsa më sipër mbështetur në arsyetimet tona si dhe praktikën e KPP-së për ankimime me të njëjtin objekt, ne kërkojmë:

Anullimin e plotë të vendimit të autoritetit dhe rikualifikimin e ofertës tonë si ofertë e përgjegjshme dhe e kualifikuar.

Verifikimin tek OSHË që ikubINFO nuk është palë kontraktuale dhe si rrjedhim nuk ka detyrime ndaj OSHË-së.

Në njoftimin e kuotimit të datës 26.11.2014 rezulton se përveç kompanisë tonë pjesëmarrëse ka qenë edhe oferta e paraqitur nga operatori ekonomik Stroka Produkt d.o.o e cila është

kualifikuar si ofertë e vlefshme. Si operatorë ekonomik i interesuar në këtë procedurë prokurimi si dhe i cënuar nga trajtimi jo i barabartë dhe në kundërshtim me parimet e prokurimit publik nga ana e autoriteti kontraktor, kërkojmë vemendjen e Institucionit tuaj për rivlerësimin e ofertës së paraqitur nga bashkëpunimi i operatoreve Stroka Produkt d.o.o dhe IN2 duke marrë parasysht kërkesat tona të evidentuara si më poshtë:

Operatori ekonomik Stroka Produkt d.o.o në këtë procedurë prokurimi ka paraqitur ofertën në bashkëpunim me operatorin IN2.

Duke ju referuar LPP-së dhe VKM Nr.1, datë 10.01.2007, nëse operatorët ekonomik paraqesin ofertë si bashkëpunim duhet të respektojnë normat ligjore të përcaktuara për këtë formë bashkëpunimi.

Referuar VKM Nr.1, datë 10.01.2007, Kreu VII, pika 2, i cila shprehet se:

Bashkimi i operatoreve ekonomike

Oferta mund të paraqitet nga një grup operatorësh ekonomike, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi.

Para dorëzimit të ofertës, grupi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi.

Oferta e paraqitur nga operatorët ekonomikë Stroka Produkt d.o.o dhe IN2 nuk është në përputhje me këtë kriter sepse në kontratën e JV nuk janë të shprehura qartë pjesët e shërbimit, punës ose furnizimit që do angazhohet secili prej antarëve në realizimin e kontratës. Në asnjë dokument të ofertës nuk janë evidentuar elementet konkrete që do të kryejë secili nga antarët gjë e cila sjell jo konformitet me rregullat e prokurimit publik.

Gjithashtu oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve është në kundërshtim me VKM Nr.1, datë 10.01.2007, "Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë grupi, i marrë së bashku, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarreveshje. ", sepse dokumentat e paraqitura nuk e respektojnë këtë raport. Në dokumentin financiarë në të cilin autoriteti duhet të verifikojë ruajtjen e përqindjes së raportit të deklaruar nga operatorët në ofertë dhe vërtetësinë e tij nuk rezulton të respektohet raporti i deklaruar sepse vlerat e përqindjeve rezultojnë të nryshme nga ato të deklaruar.

Pjesëmarrja e kompanive në raport me përqindjen e deklaruar nuk respektohet as në kërkesat teknike më saktësisht tek kontratat e ngjashme të dorëzuara (të cilat nënkuptojnë se tregojnë së për çfarë pjesë shërbimesh do të angazhohet secili prej antarëve të bashkëpunimit).

Në dokumentat standarte të tenderit kërkohet:

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Në kundërshtim me këtë kriter kontratat e ngjashme të dorëzuara nga operatorët ekonomike nuk janë dorëzuar në formën e kërkuar nga DST. Kontratat dhe dokumentat shoqërues nuk janë të noterizuara për të verifikuar vërtetësinë e kopjes me origjinalin, ato janë paraqitur si fotokopje

dhe shoqërohen vetëm nga vërtetimi i përkthimin. Këto dokumenta të paraqitura janë në shkelje edhe të Ligjit për Noterinë.

Në Shtojcën 7, "Kapaciteti teknik" kërkohet kriteri kualifikues:

Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i çertifikuar sipas sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001-2008.

Mbështetur në LPP dhe VKM sipas të cilit secili prej antarëve duhet të përmbushi kriteret ekonomike, financiare, profesionale dhe teknike në raport me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkëpunim si dhe bazuar në praktiken e prokurimit publik dhe në vendimet e dhëna nga Agjencia e Prokurimit Publik, në rastet e bashkëpunimit të dy ose më shumë operatorëve ekonomike duhet që secili prej tyre të paraqesi cilësi të aprovuar nga organet përkatëse të akredituara.

Në ofertën e paraqitur nga operatorët ekonomike, operatori ekonomik Stroka doo nuk ka paraqitur ISO 9001:2008.

Në Shtojcën 7, "Kapaciteti ekonomik dhe financiar", kërkohet kriteri kualifikues:

Një çertifikatë të gjendjes financiare nga një ose më shumë banka lëshuar jo më parë se 15 ditë nga data e hapjes së ofertave dhe me vlerë 10% të fondit limit.

Mbështetur në LPP dhe VKM sipas të cilit secili prej antarëve duhet të përmbushi kriteret ekonomike e financiare në raport me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkëpunim operatori IN2 ka paraqitur një vërtetim bankar i cili në kundërshtim me kërkesën e tenderit është jashtë afatit 15 ditor të përcaktuar.

Në dokumentat standarte të tenderit kërkohet:

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Në kundërshtim me këtë kriter kontratat e punës të stafit si dhe çertifikatat profesionale të dorëzuara nga operatorët ekonomike nuk janë dorëzuar në formën e kërkuar nga DST. Kontratat dhe dokumentat shoqërues nuk janë të noterizuara për të verifikuar vërtetësinë e kopjes me origjinalin, ato janë paraqitur si fotokopje dhe shoqërohen vetëm nga vërtetimi i përkthimin. Këto dokumenta të paraqitura janë në shkelje edhe të Ligjit për Noterinë.

Në dokumentin e publikuar nga autoriteti "Modifikim në dokumentat e tenderit me objekt", kërkohet:

"Për personelin teknik të mësipërm të kërkuar, operatori duhet të paraqesë kontratat e punës dhe formularët E-Sig për muajt korrik gusht-shtator 2014.

Në ofertën e Stroka d.o.o është paraqitur në vend të formularëve E-Sig është paraqitur vërtetimi i sigurimeve, por nuk përfshin periudhën shtator sipas kërkesës së DST-së.

Në dokumentat standarte të tenderit kërkohet:

Rastet e mos dorëzimit të një dokumenti ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Operatori IN2, në kundërshtim me kërkesën e sipërcituar ka paraqitur kontata me të dhëna të pasakta sepse ato nuk kanë kohëzgjatje të përcaktuar gjithashtu edhe vërtetimi i paraqitur për to nuk mban datë. Në këtë mënyrë autoriteti nuk mund të përcaktojë fituese një ofertë e cila në

dokumentacionet e paraqitura nuk mund të vleresohet nëse janë apo jo në përputhje me kërkesën e DST-së për periudhën e kërkuar.

Në dokumentat standarte të tenderit, faqja 50, paragrafit "Licensimi i produktit" kërkohet:

"Cdo zgjidhje e ofruar duhet të shoqërohet me liçensat e nevojshme të sistemin operativ si edhe të të gjithë software-ve të përfshirë në këtë zgjidhje"

Në ofertën e Stroka Produkt d.o.o janë ofertuar liçensat si më poshtë: 1 ëindoës Server 2012 standart

I Microsoft SQL server 2014 Standard 5x Cal-e përdoruesish për SQL server

Në përcaktimin e liçensimit të produkteve Microsoft, nga ana e operatorit ekonomik Stroka Produkt d.o.o ka mangësitë në përmbushje të specifikimeve teknike të kërkuara në DST për elementet e renditura si më poshtë:

Janë kërkuar 4 cope Server, sistemi operativ i të cilëve është windoës server. Në këtë rast nga ana e kompanisë duhet të ishin kuotuar 4 licensa windoës Server 2012 standart.

*Serverat kanë 2 CPU*8 Core. Licensimi i bërë prej kompanisë për zgjidhjen e ofruar më Datawarehouse dhe BI, nuk është i saktë, pasi version SQL Server 2014 Standard nuk e ofron mundësinë e Datawarehouse si dhe ofron mundësi të reduktuara BI. Si rezultat, minimalisht duhet të ishte kuotuar versioni SQL Server BI Edition. Në këtë rast liçensimi bëhet për Core dhe duhen respektuar mënyra e liçensimit zyrtart të Microsoft ku thuhet që liçensimi i SQL server për Core fillon minimalisht me 4 core dhe përshkallëzohet deri në mbulimin e plotë të të gjitha core-ve në cdo server fizik ku do të instalohet SQL server.*

Përsa më sipër autoriteti kontraktor në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik ka kualifikuar një ofertë të pavlefshme, specifikimet e së cilës bien ndesh me dokumentat e tenderit. Konkretisht është shkelur Neni 53 "Shqyrtimi i ofertave" sipas së cilit:

Autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e Prokurimit Publik ka pranuar një ofertë e cila nuk përmbush kriteret e vendosura nga ky ligj. Konkretisht është shkelur Neni 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 5, sipas të cilit:

Autoriteti kontraktor nuk e pranon nje ofertë:

kur ofertuesi nuk është i kualifikuar;

c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 54 të këtij ligji;

Autoriteti në shkresën e dërguar me nr.26480/6, date 04.12.2014, nuk ka kthyer asnjë përgjigje në lidhje me të gjitha pretendimet tona për ofertën e paraqitur nga operatorët ekonomike Stroka Produkt d.o.o dhe IN2.

Përsa më sipër ne kërkojmë:

Rivlerësimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve Stroka produkt d.o.o dhe IN2 dhe skualifikimin e saj si ofertë të papërgjegjshme dhe të pakualifikuar"

II.7. Në datën 17.12.2014, nëpërmjet shkresës nr. 32674/1 prot., me objekt: "Dërgim dokumentacioni", është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor

Arsyeton

III.1. Në lidhje me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “ikub INFO” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, duke qenë se;

III.1.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 7, pika 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, tek “Kriteret e veçanta për kualifikim”, në pikën 3 përcaktohet:

“Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik, që është i rregjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara, në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5(pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.”

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues për plotësimin e këtij kriteri, ai ka paraqitur;

- Vërtetim Debie nr. 28 prot., i datës 27.10.2014, ku citohet: [...] ..vërtetojmë se për kërkesin **ikubINFO** ..., pas verifikimeve të kryera në Sistemin e Faturimit, titullar i së cilës/cilave është **ikubINFO**, rezulton të ketë 0.00 lekë (zero) detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 27.08.2014, pa përfshirë faturën koherente të muajit SHT 2014. [.....]

Bashkëlidhur lista e kontratave të furnizimit me energji elektrike për të cilat lëshohet ky vërtetim debie.

1. TR2A120101104308 itd SH.P.K me adresë M. Toptani (dt.v.m.17.11.10)k; Tiranë

III.1.3 Gjithashtu, bashkëngjitur ankimit të tij me datë 25.11.2014 ankimuesi ka paraqitur ndër të tjera dokumentacionin.

- Vërtetim Debie nr. 33 prot., i datës 03.12.2014, ku citohet: [...] ..vërtetojmë se për kërkesin **ikubINFO** ..., pas verifikimeve të kryera në Sistemin e Fatutimit, titullar i së cilës/cilave është **ikubINFO**, rezulton të ketë 0.00 lekë (zero) detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 29.10.2014, pa përfshirë faturën koherente të muajit NEN 2014.[...]

Bashkëlidhur lista e kontratave të furnizimit me energji elektrike për të cilat lëshohet ky vërtetim debie.

Të dyja dokumentacionet e paraqitura nga ankimesi (III.1.2., III.1.3.) i referohen shoqërisë ikubINFO sh.p.k..

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”*.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”*

Sqarojmë se, kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi.

Sa më sipër, Komisioni gjykon se, me anë të dokumentacionit që ka paraqitur në sistemin elektronik cituar (III.1.2) ankimesi nuk e ka plotësuar kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor pasi, vërtetimi i paraqitur nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar, procedura e prokurimit e publikuar me datë 10.10.2014 dhe parashikuar për t’u zhvilluar në datë 10.11.2014.

Gjithashtu sqarojmë se, referuar Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 48, pika 1 dhe 4, neni 52, pika 6 dhe neni 53 pika 1 dhe 3, Komisioni konstaton se, *autoriteti kontraktor përcakton vendin, datën dhe orën e paraqitjes së ofertave*. Për paraqitjen e ofertave, referuar atyre që dorëzohen në rrugë elektronike, ligji përcakton se: *“Ofertat e marra pas mbarimit të afatit të fundit të paraqitjes së tyre u kthehen të pahapura ofertuesve, që i kanë paraqitur ato”*.

Në këtë mënyrë autoriteti kontraktor i hap të gjitha ofertat në datën, vendin dhe kohën e përcaktuar në dokumentet e tenderit, pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose pas mbarimit të afatit përfundimtar, të përcaktuar pas zgjatjes së këtij afati, në përputhje me procedurat e specifikuara në dokumentet e tenderit, sipas rregullave të prokurimit me mjete elektronike. Përgjatë shqyrtimit të ofertave, nga ana e autoritetit kontraktor nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme pasi që autoriteti kontraktor, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të ligjit të prokurimeve.

Në përfundim Komisioni gjykon se, cdo dokument paraqitur pas fazës së shqyrtimit e vlerësimit të ofertave, që lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë me përmbushjen ose jo të një kriteri kualifikues e jo thjeshtë një kriteri konkurrues, cënon objektin dhe qëllimin e prokurimeve publike si dhe parimet e përzgjedhjes, përcaktuar qartë në nenin 1 dhe 2 të ligjit të prokurimeve.

Është detyrim i operatorëve ekonomikë që të vërtetojnë se përmbushin të gjitha kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, si dhe referuar ditës së hapjes së ofertave të vërtetojnë që nuk ka asnjë detyrim të energjisë elektrike të maturuar.

Përsa më sipër, pretendimi i parashtruar nga operatori ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e dytë të operatorit ekonomik “ikubINFO” sh.p.k., për kualifikimin e padrejtë të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Stroka produkt” sh.p.k dhe “IN2” sh.p.k, pasi: “...[...]

III.2.1. Në ankimin drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, operatori ekonomik “ikubINFO” sh.p.k., përveç skualifikimit të tij, kundërshton edhe kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Stroka produkt” sh.p.k dhe “IN2” sh.p.k.

III.2.2. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se: “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin”.

III.2.3 Në Vendimin KPP 7/2013, Komisioni i Prokurimit Publik është shprehur se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshëm për të mbrojtur. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtëpërdrejtë e real, nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Për pasojë ky pretendim i operatorit ekonomik “ikubINFO” sh.p.k. nuk merret në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, **Komisioni i Prokurimit Publik**, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “ikubINFO” sh.p.k, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*” me objekt: “*Zhvillimi dhe Implemetimi i Business Intelligence (BI)*”, me fond limit 23 333 333 (njëzet e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 10.11.2014 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën përkatëse për shqyrtimin e mosmarrëveshjes administrative.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1905 Protokoli, Datë 12.12.2014

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Juliana Hoxha

Anëtar
Spiro Kuro

Anëtar
Leonard Gremshi

Kryetar
Gentian Këri